



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

**RELACION**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 94 DATË 28.12.2021 " PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2022 DHE PBA 2022-2024 " i ndryshuar, (shtesë dhe detajim i fondeve për mbështetjen financiare të menjëhershme për zbutjen e impaktit të krizës)**

Të nderuar këshilltarë!

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 40, pika 1, neni 41, pika 2"b", neni 54, gërma "dh", neni 64 gërma "c", ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 6, gërma "d", neni 28, pika 4, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar , të ligjit nr. 115/2021 "Për Buxhetin e vitit 2022", Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022",

paraqesim propozimin për shtesë në buxhetin e Bashkisë Berat të vitit 2022, me fondin e transferuar për mbështetje financiare për funksionin e arsimit parashkollor dhe funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, si edhe detajimin e fondit , si më poshtë :

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 898 datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës ", Aktit Normativ nr. 19 datë 29.12.2022 " Për disa ndryshime në ligjin nr 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar,

me anë të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 130 prot datë 05.01.2023 "Dërgohet mbështetja financiare për funksionin e arsimit parashkollor dhe funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi",

Bashkisë Berat i është akorduar shtesë fondi në transfertën e pakushtëzuar specifike shuma 2,900,000 Lekë për mbështetje financiare për funksionin e arsimit parashkollor dhe funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Kjo transfertë është dërguar me strukturë buxhetore për Bashkinë Berat (qendër) dhe në llogarinë ekonomike 604 "Transferta korrente të brendshme".

Është e nevojshme që fondi të detajohet në llogarinë ekonomike 606 "Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë", dhe gjithashtu të bëhet transferimi i fondit për mbështetje financiare për funksionin e arsimit parashkollor tek Njësia Shpenzuese Drejtoria Arsimore Bashkia Berat.

Propozojmë detajimin e shtesës së fondit të transfertës së pakushtëzuar specifike prej 2,900,000 Lekë për mbështetje financiare për funksionin e arsimit parashkollor dhe funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi sipas strukturës buxhetore të mëposhtme :



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**

Kod Institucioni		Titulli i Progr.	Kapitull	Artikull	Kod Projekti	Emërtimi i Projektit	Lekë
2102001	Bashkia Berat (qendra)	03280	01	606	9999999	Transferta për Buxh. Fam. & Individë ( mbështetje financiare)	620,000
2102005	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	09120	01	606	9999999	Transferta për Buxh. Fam. & Individë ( mbështetje financiare)	2,280,000
<b>Totali i Shtesave</b>							<b>2,900,000</b>

Gjithashtu, me email zyrtar të MFE në datën 06 janar 2023 na është komunikuar transferta prej 4,816,179 lekë, fond i TAP të tremujorit të fundit të 2022, i cili mund të përdoret për zbatimin e VKM-së nr 898 datë 29.12.2022 .

Propozojmë detajimin e fondit prej 4,816,179 lekë si më poshtë :

Kod Institucioni		Titulli i Progr.	Kapitull	Artikull	Kod Projekti	Emërtimi i Projektit	Lekë
2102004	Agjencia e Shërbimeve Publike	04520	01	606	9999999	Transferta për Buxh. Fam. & Individë ( mbështetje financiare)	606,000
2102004	Agjencia e Shërbimeve Publike	06260	01	606	9999999	Transferta për Buxh. Fam. & Individë ( mbështetje financiare)	1,884,000
2102004	Agjencia e Shërbimeve Publike	06440	01	606	9999999	Transferta për Buxh. Fam. & Individë ( mbështetje financiare)	200,000
2102005	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	09120	01	606	9999999	Transferta për Buxh. Fam. & Individë ( mbështetje financiare)	1,186,179
2102005	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	10430	01	606	9999999	Transferta për Buxh. Fam. & Individë ( mbështetje financiare)	940,000
<b>Totali i Shtesave</b>							<b>4,816,179</b>

2102004	<b>Agjencia e Shërbimeve Publike</b>	<b>2,690,000</b>
2102005	<b>Drejtoria Arsimore Bashkia Berat</b>	<b>2,126,179</b>

Në përfundim mund të themi që efekti total i VKM nr 898 datë 29.12.2022 për mbështetjen financiare për zbutjen e impaktit të krizës është 12,560,000 lekë. Ky efekt do të përballohet :  
- nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, pra fondet e akorduara, në shumë 7,716,179 lekë  
- nga fondet tona të buxhetit të vitit 2022, në shumën 4,843,821 lekë

<b>total fonde per mbeshtetjen financiare</b>	<b>12,560,000</b>
me fonde te derguara nga mfe :	7,716,179
me fondet tona te buxhetit 2022 :	4,843,821

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin ,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

KRYETAR

Ervin DEMO



Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

*[Handwritten signature]*

Drejtoria Juridike